



Nr. 5042 Rep.
Nr. 1684 Kol.

KONTRATË PËR SHITJE KUOTASH

Sot më datë 23/11/2017, bazuar në nenin 73 pika 1/b të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar dhe nenin 705 e vijues të ligjit nr. 7850 dt. 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", nënshkruhet përpara meje noteres Ardjana A.Mediu, me adrese ne Blv. "Deshmoret e Kombit", Kullat Binjake, Kulla 2, Kati 7, Tirane, kjo kontratë për shitjen e kuotave të Shoqërisë "Manchester Group" Sh.p.k, si më poshtë vijon:

Neni 1

Palët Kontraktuese

Z.Bradley Matthew Videgeon, i datelindjes 18.07.1953, lindur ne Mandeville dhe banues ne Londer, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me Pasaporte Britanike me numër Pasaporte 522605880, zotërues i 43 % të kuotave/pjesëve të kapitalit themeltar të shoqërisë "Manchester Group" Sh.p.k, me NIPT L71427014A.

Nga këtu e më poshtë referuar si "SHITËSI"

dhe

Z.Michael Yiu Chung Stubbs, i datelindjes 09.03.1964, lindur ne Hong Kong dhe banues ne Londer, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar prej meje me Pasaporte Britanike me numër pasaporte 801229545, zotërues i 57% të kuotave/pjesëve të kapitalit themeltar të shoqërisë "Manchester Group" Sh.p.k, me NIPT L71427014A.

Nga këtu e më poshtë referuar si "BLERËSI"

Neni 2

Objekti i Kontratës

2.1 Objekti i kontratës është shitja nga Shitësi tek Blerësi, i 43 % te kuotave, me një vlerë të përgjithshme prej ALL 43 000 (dyzetë e tremijë) lekë, që Shitësi zotëron në Shoqërinë "Manchester Group" Sh.p.k.

Neni 3

Çmimi i Shitjes.

3.1 Çmimi total i shitjes së kuotave që do t'i paguhet Shitësit nga Blerësi është 43 000 (dyzet e tremije) lekë.

Neni 4

Mënyra e Pagesës

4.1 Çmimi i shitjes së kuotave i përcaktuar në nenin 3 të kësaj kontrate, është likuiduar prej Blerësit perpara nënshkrimit të kësaj kontrate jashte zyres noteriale.

Neni 5

Detyrimet e Shitësit

- 5.1 Shitësi do të pranojë çmimin e shitjes, të parashikuar në Nenin 3, si çmimin e plotë dhe përfundimtar të shitjes së kuotave, që ai kishte në shoqërinë "Manchester Group" Sh.p.k, kuota të cilat tashmë i kalojnë Blerësit.
- 5.2 Shitësi garanton se kuotat, të cilat shiten me këtë kontratë, nuk janë të lëna peng, në dorëzani apo të rënduara me ndonjë lloj tjetër barre dhe se ai është i vetmi pronar i tyre e gëzon të drejta të plota mbi to.
- 5.3 Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Shitësi heq dorë nga të drejtat që ai kishte mbi kuotat objekt i kësaj kontrate.

Neni 6

Detyrimet e Blerësit

- 6.1 Blerësi ka paguar çmimin e blerjes, sipas mënyrës së parashikuar në nenin 4 të kësaj kontrate.
- 6.2 Blerësi do të marrë të gjitha masat për të regjistruar transferimin e kuotave që Shitësi i kalon atij, në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
- 6.3 Blerësi fiton të drejta dhe detyrime mbi kuotat objekt i kontrates menjehere pas nënshkrimit të kësaj kontrate. Detyrimet që kanë lindur përpara nënshkrimit të kësaj kontrate janë në ngarkim të Shitësit.

Neni 7

Konfigurimi pas Shitjes së Kuotave

- 7.1 Pas shitjes së kuotave konfigurimi i kuotave të shoqërisë "Manchester Group" sh.p.k do të jetë: Ortaku Z.Michael Yiu Chung Stubbs zoterues i 100 % të kuotave të shoqërisë.

Neni 8

Mosmarreveshjet


- 8.1 Mosmarreveshjet që lindin nga kjo kontratë do të zgjidhen me mirekuptim nga të dy palët, në rast të kundërt do të drejtohen Gjykatës Kompetente Shqiptare.

Neni 9

Gjuha e Kontratës dhe Hyrja në Fuqi

- 9.1 Kjo kontratë hartohet në 3 (tre) ekzemplarë, në gjuhën Shqipe, të gjitha të njëjtlëshme dhe origjinale, dhe pasi i'u lexua paleve në prezencë të përkthyeses së gjuhës angleze, Zj.Anila Berberi, e bija e Petritit, e datelindjes 15.08.1972, lindur në Bilisht, Korçë dhe banuese në Tiranë, mbajtëse e kartës së identitetit me nr. Personal H25815062P, me NIPT-L21815002P, u nënshkrua rregullisht prej tyre në prezencën time. Akti nënshkruhet dhe prej meje noterës.
- 9.2 Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e saj prej palëve.


SHITËSI


BRADLEY VIDGSON


NOTERE

Ardjana A.Mediu

BLERËSI


MICHAEL STUBBS

KONTRATË PËR SHITJE KUOTASH


Anila Berberi
ANTIBERBERI
NIPT-L21815002P